



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Nr. 13030 Prot.

Lezhë, më 31 . 10 .2025

URDHËR

Nr. 600 , Datë 31 . 10 . 2025

**“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË KONSULTIMEVE PUBLIKE PËR PBA-NË
2026-2028 DHE BUXHETIN VJETOR, SI DHE PAKETEN FISKALE TË BASHKISË
LEZHË”**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, Ligjit Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, Ligjit Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Vendimin Nr.393 datë 18.07.2022 “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Lezhë” si dhe Vendimin Nr.16, data 17.01.2025 “Për miratimin e Planit Vjetor të Kalendarit të Konsultimeve Publike për Bashkinë Lezhë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e kalendarit të konsultimeve publike për Projekt Buxhetin Afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetin vjetor 2026, si dhe Paketen Fiskale, për të gjitha njësitë administrative në Bashkinë Lezhë.
2. Konsultimet do të realizohen sipas kalendarit, në koordinim me Këshillin e Bashkisë Lezhë.

Nr	Aktiviteti	Objekti i takimit, konsultimit publik	Data	Vendi	Ora	Mënyra
1.	Konsultim publik me banorë të Njesisë Administrative Balldren, Dajç, Blinisht, Kallmet, Ungrej.	-Projekt buxheti afatmesëm 2026-2028 dhe buxheti vjetor 2026, -Taksat dhe tarifat vendore (paketa fiskale 2026).	10.11.2025	Zadrima Park	16:30	Takim publik
2.	Konsultim publik me banorë të Njesisë Administrative Zejmen, Shënkoll, Kolsh.	-Projekt buxheti afatmesëm 2026-2028 dhe buxheti vjetor 2026, -Taksat dhe tarifat vendore (paketa fiskale 2026).	11.11.2025	Restorant “Orkidea Palace”	16:30	Takim publik



3.	Konsultim publik me banorë të Njësisë Administrative Lezhë, Shëngjin, gazetarë dhe media lokale, organizata të shoqërisë civile, grupe tjera të interesit.	-Projekt buxheti afatmesëm 2026-2028 dhe buxheti vjetor 2026, -Taksat dhe tarifat vendore (paketa fiskale 2026).	12.11.2025	Pallati i Kultures	16:30	Takim publik
4.	Konsultim publik me bizneset lokale.	-Taksat dhe tarifat vendore (paketa fiskale 2026).	13.11.2025	Qendra Kulturore e Fëmijëve.	16.30	Takim publik

3. Konsultimi publik me objekt “Projekti perfundimtar i PBA-së 2026-2028 dhe buxheti vjetor” dhe “Paketa Fiskale” parashikuar për të realizuar gjatë muajit dhjetor referuar Vendimit Nr.16, datë 17.01.2025, do të realizohet gjatë muajit nëntor sipas kalendarit më sipër.
4. Rekomandimet me shkrim mund të dërgohen në adresen postare lagjja “Skenderbeg”, Sheshi “Gjergj Kastrioti”, Bashkia Lezhë dhe në adresen e emailit info@lezha.gov.al deri me datë 21.11.2025.
5. Të ngarkohet Drejtoria e Projekteve Strategjike, Evropës, Emigracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës për koordinimin e procesit të konsultimit dhe informimit rreth takimeve si dhe transparencës për publikun.
6. Të ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit si dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për mbajtjen e procesverbaleve të takimeve si drejtori përgjegjëse për hartimin e projekt-akteve.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Pjerin Ndreu

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV.KRYETARI
Brikena Vuksani

